

Република Северна Македонија
Државно правобранителство на
Република Северна Македонија



Republika e Maqedonisë së Veriut
Avokatura e Shtetit e Republikës
së Maqedonisë së Veriut



Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATURA E SHTETIT E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
ASH Nr.02-642/1
27.11.2023
Shkup

RAPORT VJETOR
PËR PUNËN E
AVOKATURËS SË SHTETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2022

Korrik
2023



Përmbajtja

I Hyrje	3
II. AKTET E BRENDESHME TË AVOKATURËS SË SHTEJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.....	9
III. AKTIVJETETET E AVOKATURËS SË SHTEJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË REALIZIMIN E FUNKSIONIT TË AVOKATURËS SË SHTEJIT.....	13
IV. BASHKËPUNIM ME ORGANE DHE ORGANIZATA TË TJERA.....	16
V. VELLIMI I PUNËS PËR VITIN 2022.....	18
1. Lëndë kontestimore.....	19
2. Lëndë administrative dhe konteste administrative.....	19
3. Mëndime juridike.....	20
4. Lëndë përmbanuese.....	20
5. Lëndë falimentimi.....	20
6. Lëndë nga metoda parandaluese të kontestit të punës.....	21
7. Lëndë jashtë kontestimore.....	22
8. Lëndë oqhezioni.....	22
9. Urdhër pages.....	22
10. Lëndë organizative.....	22
11. Të ndryshme.....	23
12. Denoncionalizimi.....	23
13. Veprime në bazë të ankesave dhe propozimeve.....	24
14. Qasje e lirë në informacionin me karakter publik.....	24
15. Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme.....	25
16. Kolegium profesional.....	25
VI. PLANI FINANCIAR VJETOR PËR VITIN 2022.....	25
VII. ARRITJET NGA LËNDËT E PUNUAR NË VITIN 2022.....	27
VIII. PJESA PËRMBYLLËSE.....	27



HYRJA

Në pajtim me nenin 34 nga Ligji për Avokaturën e Shtetit (Gazeta Zyrtare e RMV-së 87/07 dhe 104/15) Avokati i Shtetit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për punën e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku një herë në vit e informon Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky raport vjetorë për punën e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 është punuar në drejtim që Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të njohet me aktivitetet e përgjithëshim të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit 2022.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut është themeluar me Ligj për Avokatin e Shtetit (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr 87/07), i cili rregullon organizimin dhe kompetencat e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kushtet dhe procedura për emrimin dhe shkarkimin e Avokatit të Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe avokatët e shtetit, autorizimet e të drejtat dhe obligimet, mjetet për punë, qasja të informatat, bashkëpunimi me organet e administratës së shtetit dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut është organ shtetëror i cili ndërmer masa dhe mjete juridike për shkak të mbrojtjes juridike të të drejtave dhe interesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Avokatura e Shtetit i realizon kompetencat e saj në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe marrëveshjet të ratifikuara ndërkombëtare.

Qëllimi prioritar i organit është ti mbrojnë me ligjë të drejtat dhe interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut para gjykatave dhe organeve të tjera në vend dhe në veridet e huaja.

Efikasitetin në punën e tyre e arinjë në mënyrë ekipore të përbërë nga stafi i trajnuar.

Dekadat e kaluara në realizim të qëllimit për mbrojtjen juridike të shtetit, në disa aspekte, kontriboi që Avokatura e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të bëhet organ i pavarur shtetëror dhe paraqet faktor të rëndësishëm në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe interesave të shtetit.

Në pajtim të Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e vendeve të avokatëve të shtetit dhe njësisve rajonale të gjykatave ku kryhet funksioni i



Avokaturës së Shtetit nr.41-148/1 nga 8 shkurti i vitit 2022 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përcaktuar 16 vende të Avokatëve të Shtetit në njësitë rajonale të gjykatave ku kryhet funksioni i Avokaturës së Shtetit dhe atë në Shkup, Prilep, Kavadar, Gjevgjeli, Strumicë, Shtip, Manastir, Veles, Koçan, Kumanovë, Tetovë, Strugë, Kërçovë, Gostivar, Ohër dhe Dibrë.

Me vendim nr.45-5748/1 nga 20 gushtit 2019 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare 3/08, 215/2018 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 178/2019 dhe 187/2022) përcaktohet numri i avokatëve të shtetit në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe atë për njësinë rajonale Shkup 18 (tetëmpëdhjetë) avokatë të shtetit, për njësinë rajonale Gostivarë dhe Kumanovë të përcaktuar janë 4 (katër) avokatë të shtetit, për njësinë rajonale të Manastirit, Tetovës, Strugës, Kërçovës, Koçanit dhe Velesit nga 3 (tre) avokatë të shtetit për njësinë rajonale të Ohrit, Kavadarit, Gjevgjelisë, Strumicës, Shtipit dhe Prilepit nga 2 (dy) avokatë të shtetit, për njësinë rajonale të Dibrës një avokat të shtetit.

Me rregullorën pjesa nr.08-1437/7 nga 14 korrik 2008 Ministri i drejtësisë (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.89/08), përcaktohet forma dhe përmbajtja e formularit, përmbajtja, procedura dhe mënyra e lëshimit, përdorimit dhe revokim të kartelës zyrtare të Avokatit të Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe avokatëve të shtetit. Duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet ligjore, kjo rregullore duhet të ndryshohet dhe plotësohet, për të njëjtën është njoftuar disa herë edhe Ministria e Drejtësisë, por nuk ka asnjë ndryshim.

Funksionin e Avokaturës së Shtetit e kryejnë Avokati i Shtetit i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe avokatët të shtetit në Avokaturën e Shtetit.

Funksionin e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 e ka kryer Fehmi Stafa deri më 22 gusht 2022, ndërsa nga 23 gusht 2022 Avokati i Shtetit për rajonin e Shkupit Sasha Stancevski si Avokat i Shtetit i përcaktuar në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit.

Selia e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është në Shkup në Rr. Bul.Goce Dellçev nr.18, në ndërtesën e Kompanisë të transmetimit publik "Radio dhe televizioni kombëtar" në katin e VI-të.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka marrë Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008, nën numrin e regjistrimit Q 1084/0 nga 12.12. 2014.



Në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka gjithsej të punsuar 168 persona, nga të cilët 47 persona të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga gjithsej 50 Avokatë të Shtetit në të gjitha njësitë rajonale ku ushtrohet funksioni i Avokatit të Shtetit, në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e numrit të avokatëve të shtetit në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 173/2019 dhe 187/2022) aktualisht janë emëruar 47 avokatë të shtetit. **Vërejmë se është urgjentisht i nevojshëm emërimi i avokatëve të shtetit të tjerë , sepse funksionimi i Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është tepër i vështirë, veçanërisht në njësitë rajonale të caktuara ku aktualisht ka vetëm një avokaturë të shtetit (Veles dhe Tetovë, dhe në njësinë rajonale të Ohrit aktualisht nuk ka Avokati të Shtetit. Njësia rajonale e Dibrës nuk është ende e hapur sepse nuk është emëruar Avokati i Shtetit, dhe në të njëjtën kohë Ministria e Financave nuk lejon punësimin e nëpunësve administrativë në këtë njësi rajonale.)**

Në Avokaturën e Shtetit të Republikën së Maqedonisë së Veriut janë gjithsej 121 nëpunës administrativ. Nëpunësit shtetëror gjithsej janë 116, ndërësa ka të punësuar që nuk kanë statusin e nëpunësit shtetëror dhe janë gjithsej 5. Udhëheqës të nëpunësve administrativ janë gjithsej 4 dhe atë: këshilltarë shtetëror 1, udhëheqës sektori 1 dhe udhëheqës të njësisë 2 përmbaues. Nga kategoria nëpunësve profesional administrativ gjithsej janë 88 nga të cilët: këshilltar 16, bashkëpuntorë të lartë 2, bashkëpuntorë 1, bashkëpuntorë të rinj 62. Nëpunësat profesional të nëpunësve administrativ-ndihmës janë gjithsej 29 prej të cilëve: referent të pavarur 2, referent të lartë 13, referent 7, referent të rinj 1.

Nga gjithsej 168 nëpunësve me arsimë të lartë janë 134 nga të cilët 47 avokatë të shtetit dhe 36 nëpunësat administrativ , me arsimë të lartë 1, me arsim të mesëm janë 28. Nga 5 nëpunësat që nuk kanë statusin e nëpunësit shtetëror, 3 janë me arsim të mesëm dhe 2 me arsim fillor.

Nga numëri i përgjithshëm i të punësuarve 168, burra 71 dhe gra 97. Nga numëri i përgjithshëm i funksionarëve 47: burra janë 21, gra 26, nga të cilët 35 janë maqedonas, 11 shqiptarë dhe 1 Vlleh.



Nga numëri i përgjithshëm i nëpunësve shtetëror 121: burra janë 50, gra 71, dhe nga numëri i përgjithshëm i të punësuarve që nuk kanë status të nëpunësit shtetëror 5; burra janë 3, a gra 2. Nga 116 nëpunësat administrativ, maqedonias janë 38, shqiptarë 58, serbë 4, turq 3, dhe boshnjakë 1. Nga gjithsej 168 nëpunësat shtetëror-funksionar dhe nëpunësat administrativ-maqedonasit janë 70, shqiptarët 80, serbë 4, turq 3, boshnjakët 1, romë 2 dhe vllahët 1.

Me Vendimin nr 42-11173/2-14 nga 8 janari 2015 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.4 nga 12 janari 2015 në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i është dhënë në shfrytëzim hapsirë administrative e cila gjendet në Bulevar "Goce Delçev" nr. 18-Shkup, KP nr.12231,KO Qendër 1, me sipërfaqe nga 700m2, e regjistruar në fletëpronësi nr. 98456, në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në ndërtesën e ndërmarjes radiodifuzive publik" Radiotelevizioni nacional në katin VI-të).

Duke marrë parasysh rritjen e numrit të Avokatëve të Shtetit për njësinë rajonale të Shkupit dhe rritjen e numrit të të punësuarve në Avokaturën e Shtetit në njësinë rajonale të Shkupit, është e nevojshme gjetja e hapësirës të përshtatshme që do të ofronte kushte elementare për punë, sepse për momentin nuk ka hapësirë të mjaftueshme që funksioni i avokaturës së shtetit të zhvillohet normalisht dhe as puna e përgjithshme nuk zhvillohet. Aktualisht, në çdo zyrë ka dy avokatë të shtetit, gjë që e vështirëson punën normale të çdo avokati të shtetit. Në një zyrë janë tre, katër dhe tetë nëpunës administrativ, gjë që e vështirëson kryerjen normalisht të detyrës për secilin prej tyre.

Më vendim nr.19-5453/1 nga 2 dhjetorë 2008 të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut iu dha në shfrytëzim hapsirë administrative në Prilep në sipërfaqe nga 117,20M2 dhe me Vendim nr.23-3275/1 të 7 korriku 2003 të Qeverisë së Republikën së Maqedonisë së Veriut, Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut iu transferua e drejta për shfrytëzim një pjesë nga kati përdhese me një sipërfaqe nga 570,79M2 në Manastir.



Me Vendimin nr.19-3495/1 të 12 gushtit 2008 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Avokatit i Shtetit të Republikës së Maqedonisë në Strugë i është lejuar shfrytëzimi i hapësirës administrative-afariste në Strugë me sipërfaqe prej 17,1 m², dhe pjesë e dhomës me sipërfaqe 7,98m² e cila gjendet në objektin e Gjykatës Themelore të Strugës në rr. „Strushki Kepensi”bb, me numër KP 1215/1 e regjistruar në IL 2948 për KO Strugë.

Me vendim nr.44-593/1 të datës 4 shkurt 2020 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokaturës të Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Tetovë i është lejuar shfrytëzimi i hapësirës administrative-afariste me sipërfaqe prej 79m², i cili gjendet në rrugën „„Ilindenska” bb në Tetovë në KP 13419, KO Tetovë 3.

Njësit e mbetura të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të vendosura dhe shfrytëzojnë hapësirat e gjykatave, përveç njësisë rajonale Kavadar e cila shfrytëzon hapësirën në vetëqeverisjen lokale në Komunën e Kavadrin dhe njësinë rajonale të Kërçovës, e cila shfrytëzon hapësirën e dhënë me qira, sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka veb faqen:
www.drzavnopravobranitelstvo.gov.mk, dhe e-mail adresa: dpkopje@dp:sm.gov.mk.

Në zbatim të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Entit Shtetëror për Revizion 01 2019 03 10 prill 2020 nga data 02-04 nëntor 2021 përfaqësuesit e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 10.02.2022 mbajtën takim pune me Përfaqësuesja Gjyqësore e Republikës së Francës znj. Llop Badie (Laure Bédier) në Paris, që ishte takimi i parë i tillë mes dy institucioneve shtetërore. U shkëmbyen përvoja në lidhje me kompetencat e këtyre dy institucioneve vendosjen dhe organizimin e tyre. Para këtij takimi u mbajt takim me Shkërkuesin e saj Ambasadorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Republikën e Francës, znj. Jadranka Chaushevska Dimov, në ambientet e Ambasadës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Republikën e Francës, në funksionin e koordinimit para takimit të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Fahmi Stafa me homologen franceze, Llop Bedie (Laure Bédier),

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë muajit mars 2022 ka mbajtur takim pune me përfaqësuesen e Bankës Botërore, Bozhena Lipej, me të cilën është realizuar Projekti Modernizimi i Bujqësisë - Menaxhimi Bujqësor, Efektiviteti dhe Konkurrueshmëria dhe Përmirësimi i Bujqësisë. Menaxhmenti është



shqyrtuar, përmes autoritetit që ka Avokatura e Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Avokati i Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fehmi Stafa, gjatë muajit maj, me ekipin e tij realizoi një vizitë të suksesshme në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Italisë në Romë.

Pritja e bërë nga Avokatura e Shtetit të Republikës së Italisë znj. Gabriella Palmieri Sandulli dhe ekipi i saj ishte me nderimet më të larta, për të cilën shprehim mirënjohjen tonë të veçantë. Në takim u shkëmbyen përvoja, u konstatuan ngjashmëri dhe dallime në punën e dy institucioneve. U konstatua se ky bashkëpunim duhet të vazhdojë me vizitë kthjese nga Avokatura e Shtetit të Republikës së Italisë znj. Gabriella Palmieri Sandulli dhe ekipi i saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në të njëjtën periudhë, Avokati i Shtetit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fehmi Stafa, me ekipin e tij, vizitoi Ambasadën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Romë dhe pati një takim me Shkëlqesinë e tij Ambasadorin Vesel Memedi.

Avokati i Shtetit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fehmi Stafa dhe ekipi i tij, vizituan Ambasadën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Vatikan dhe u takua me Shkëlqesinë e saj ambasadorin Maria Efremova.

Avokati i Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fehmi Stafa dhe zëvendësambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, z. Otto Graf, mbajtën një takim më 7 qershor 2022, ku u diskutuan disa çështje, përfshirë luftën kundër nivelit të lartë. korrupsionit.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbështet nga Shkëlqesia e tij në luftën kundër korrupsionit të lartë.

Zëvendës ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë, z. Otto Graf, theksoi se kjo është një rrugë dhe tregues i mirë, të cilin duhet ta ndjekin të gjitha institucionet, drejt realizimit të qëllimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të hyrë në Bashkimin Evropian.



Në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit 2021-2025 të Komisionit Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit, nga dhjetori 2020 në pikën 5.2, ndër problemet prioritare në sektorin e drejtësisë, efikasiteti dhe transparenca e pamjaftueshme në punën e u përcaktua ndër të tjera edhe Avokatura e Shtetit. Për zgjidhjen e këtij problemi është planifikuar të miratohet ligji i ri për avokaturën e shtetit.

Dhe Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e mendimit se duhet të miratohet ligj i ri në të cilin do të përcaktohen më hollësisht kompetenca, përgjegjësia dhe organizimi i vetë autoritetit, dhe në drejtim të rekomandimeve të paraqitura në Raportin Përfundimtar 01 2019 03 10 Prill 2020 të Entit Shtetëror të Auditimit dhe në pajtim me arsyetimin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të interesit 2021-2025 .

II AKTET E BRENDSHME TË AVOKATURËS SË SHTESTIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.

Në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullorja për organizimin e brendshëm të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ASH nr.02-141/20-1 datë 03.06.2020 me organogram dhe Rregulloren për janë në fuqi sistematizimi i vendeve të punës në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ASH nr.02-141/20-2 nga 03.06.2020, ASH nr.02-141/20-3 nga 23.02.2021, ASH nr.02-141/20-4 nga 16.03.2021, ASH nr.02-141/20-5 nga 22.06.2021, ASH nr.02-141/20-6 nga 24.12.2021, ASH nr.02-141/20-7 nga 07.02.2022 dhe ASH nr.02-141/20-8 nga 15.06.2022, i cili ka pësuar tetë ndryshime, plotësime dhe harmonizime në pajtim me Ligjin për marrjen në detyrë të zyrtarëve administrativë të punësuar përmes K- 5 programit të Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndër-Komuniteteve (Gazeta Zyrtare e RMV-së 302/2020) si dhe në pajtim me Planin për marrjen në detyrë të nëpunësve administrativë të pacaktuar të punësuar përmes programit K-5. Në pajtim me akte e brendshme janë themeluar 3 sektore dhe atë Sektorin e Administrimit e Burimeve Njerëzore në 2 njësi: Njësia për zhvillim dhe trajnim organizativ dhe Njësia për regjistrime personale, Sektor për punë juridike, të



përgjithshme dhe të përbashkëta me 3 njësi: Njësia e përkthimit dhe Sektori i çështjeve financiare dhe 2 njësi; Njësia për koordinimin e buxhetit, kontrollin e buxhetit, koordinimin e përkurimit publik, ndjekjen dhe planifikimin strategjik dhe Njësi e kontabilitetit dhe pagesave. Si njësi e pavarur është formuar Njësi për revizion të brendshëm.

Është sjell Plan Vjetorë për punë të Avokaturës Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 ASH. nr.02-596/1 nga 29.12.2021 ndryshimet dhe protësimit ASH. nr.02-408/1 nga 29.04.2022 dhe ASH. nr.02-408/2 nga 20.06.2022, ASH. nr.02-408/5 nga 21.06.2022, ASH. nr.02-408/7 nga 07.07.2022 dhe ASH. nr.02-408/8 nga 26.08.2022, ASH nr.02-408/9 nga 22.09.2022, ASH nr.02-408/10 nga 07.10/2022, ASH nr.02-408/11 nga 10.10.2022, ASH nr.02-408/12 nga 19.10.2022 dhe ASH nr.02-458/13 nga 21.11.2022.

Në pajtim me nenit 32 të Ligjit për Nëpunësat Administrativ (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së 275/19 dhe 14/20) dhe nenet 20a dhe 20b të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.27/14, 199/14, 27/16 35/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.143/19), dhe neni 9 nga Metodologjia për planifikimin e punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.63/16). Avokatura e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përpunuar Planin Vjetorë për punësim për vitin 2022, ASH nr.04-318/1 në 05.08.2021. Ky plan vjetor është kërkuar të rishikohet nga Ministria e Financave, kështu që pas rishikimit dhe planifikimit të 6 punësimeve, 6 avansime dhe një pensionim. Ministria e Financave nuk ka marrë vendim, për këtë arsye është konsideruar se është mendim pozitiv dhënë në përputhje me nenin 20-b paragrafin 6 dhe paragrafin 10, dhe i është dorëzuar Ministrisë së Shoqërisë Informativë dhe Administratës, e cila ka dhënë pëlqimin më 23.12.2021. Pas kërkesës për publikim të shpalljes publike nga Ministria e Financave, nuk është dhënë mendim pozitiv për shkak se nuk është dhënë mendim pozitiv për planin bazë vjetor të punësimit nga ana e tyre. Me dorëzimin e planit të ri vjetor të rishikuar në Ministri, i cili parashikonte 1 punësim, 8 avansime dhe 1 pensionim, u mor pëlqimi i Ministrisë së Financave më 05.05.2022. Megjithatë, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës nuk ka paraqitur mendim pozitiv për këtë plan vjetor për arsye që më parë ka dhënë mendim pozitiv për plan tjetër vjetor. Për shkak të koordinimit të dy ministrive, nga data 05.07.2022 është përgatitur plani vjetor i rishikuar i punësimit për vitin 2022, i cili është miratuar nga Ministria e Financave më 29.07.2022 dhe nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe



Administrates 23.12.2022, pra më 26.12.2022. Janë dhënë dy raporte gjashtëmujore për zbatimin e Planit Vjetor të Punësimit. Në pajtim të Raporteve për zbatimin e Planit Vjetor të Punësimit në vitin 2022, nuk është kryer asnjë punësim, por nuk është bërë avansime në detyrë dhe 11 persona janë larguar nga institucioni për arsye të ndryshme.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar Plan Strategjik për vitin 2023-2025 ASH. nr.02-1052/1 nga 24.08.2022.

Plani Strategjik i Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është dokument strategjik përmes së cilit janë definuar aktivitetet për arritjen e qëllimit të tij konkret dhe unik. Plani Strategjik për periudhën nga viti 2024 deri më vitin 2026, është vazhdim në kontinuetet i qëllimeve strategjike dhe të prioritetëve të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, programet, aktivitetet, burimet e nevojshme dhe mjetet financiare për realizimin e tyre si dhe rezultatet e pritura. Si përfaqësues ligjor i shtetit, Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut qëllimet e saj strategjike i përcakton nëpërmjet përparsive strategjike të Qeveris të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në sferën e veprimit.

Prioritetet Strategjike dhe qëllimet e Avokaturës së Shtetit rrjedhin me Vendim përcaktimin e Prioriteteve Strategjike të Qeveris të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 (Gazeta Zyrtare në RMV-së nr.97/21)) që nënkupton zhvillimin e suksesshëm të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, sundimin e ligjit, pavarësinë e gjyqësorit, luftën konsistente dhe jo selektive kundër krimit dhe korrupsionit me transparencë të gjerë dhe të detyrueshme.

Prioritetet Stratigjike dhe qëllimet e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë Veriore janë:

1 Mbrojtja juridike e të drejtave pronësore dhe interesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organëve shtetërore të themeluara me ligj

Nga ky prioritet burojn qëllimet e mëposhtme:

-Gjithnjë, me rregull, në kohë të merren të gjitha masat juridike dhe mjetet në proceset që zbaton para gjykatave dhe organëve dhe institucione të tjera



- Sjellje të Programit Vjetor të punës së Avokaturës Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022
- Përgatitje e planit të prokurimit publik për vitin 2022
- Përgatitje e planit financiar për vitin 2022
- Të përpunohen raporte gjysmë vjetore rreth zbatimit të Ligjit për veprimin ndaj parashirosave dhe propozimeve
- Të përgatitet Informacion vjetor për zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik
- Të përgadisë informacion raporte gjysmë vjetore për zbatimin e Ligjit për parandalim të korupsionit dhe konfliktit të interesave
- Të përgatitet Plan Vjetor të punësimit për vitin 2023 dhe përgatitja e raporteve gjashtëmuajore
- Zbatimi i Planit Vjetor të punësimit për vitin 2022
- Të përgadisë Planë Vjetor për trajnim për vitin 2021 dhe të përgadisë raportë gjysmë vjetore për zbatimin e Planit Vjetor të trajnimit
- Të mbahen puntori (seminare) në nivel të avokatëve shtetëror, të stafit profesional dhe stafit profesional-administrativ
- Të vendosen mbrojtje back up (kopje të të dhënave për vendndodhjen e jashtme) të dokumenteve në Avokaturën e Shtetit të RMV-së
- Promovimi dhe koordinimi i procesit funksional të planifikimit strategjik
- Përmirësimi i cilësisë së procesit të planifikimit strategjik dhe forcimi i integritetit me procesin buxhetor
- rritja e kapaciteteve institucionale për përgatitjen dhe zbatimin e planit strategjik, vlerësimin dhe raportimin e rezultateve të arritura,
- ruajtja e komunikimit dhe bashkëpunimit të përditshëm me departamentet në ASHRMV-së përmes takimeve të punës konsultative dhe këshilluese
- bashkimi i ASHRMV-së në Platformën Kombëtare për Ndërveprim

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut zbaton plotësisht dispozitat e Ligjit për qasje të lirë deri në informatat me karakter publik, sipas të cilit emërtohen zyrtarët që ndërmjetësojnë në informatat me karakter publik të krijuara apo i posedon Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me kompetencat e tyre në 15 njësit rajonale në të cilat kryhet funksioni i avokaturës së



shtetit. U miratua Raport Vjetor mbi zbatimin e Ligjit për qasje të lirë të informacionin me karakter publik për vitin 2022 deri tek Komisionin për mbrojtjen e të drejtave për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

Lista e personave që ndërmjetësojnë në informatat me karakter publik të krijuar ose në dispozicion të Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me kompetencat e saj në të gjitha 15 njësitë rajonale në të cilët kryhet funksioni i avokaturës së shtetit, është i publikuar në Veb faqën e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

III. AKTIVITETET E AVOKATURËS SË SHTEBIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË REALIZIMIN E FUNKSIONIT TË AVOKATURËS SË SHTEBIT .

Aktivitetet dhe puna e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit 2022, rrjedhin nga autorizimet, të drejtat dhe detyrimet që Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka në pajtim me Ligjin për Avokaturën e Shtetit, ligjet sistemore dhe aktet e tjera nënligjore.

Avokatura e Shtetit, në punën e saj, zbaton ligjet, rregullore dhe aktet nënligjore që rregullojnë çështje juridike në disa fusha të ligjit, siç janë: Ligji për detyrimet, Ligji për pronën dhe të drejtat e tjera të patundshme, Ligji për denacionalizëm, Ligji për tokë ndërtimore me akte nënligjore, rregulloret në lidhje me transformimin e kapitalit shoqëror dhe shitjen e kapitalit shtetëror, Ligji për procedurën kontestimore, Ligji për përmbarim, Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, Ligji për shpronësim, Ligji për falimentimin, Ligji për noterinç, Ligji për procedurën penale në fushën e kërkesave dhe rregulloret e tjera ligjore.

Puna në Avokaturën e Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut e bazuar në ligjet e mëposhtme:

- Ligj për Avokaturën e Shtetit (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.87/87 dhe 104/15).



- Ligj për privatizimin dhe qiranë truallit ndërtimor në pronësi shtetërore (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.4/05, 13/07, 165/08, 146/09, 18/11, 51/11, 27/14, 144/14, 72/15, 153/15, 23/16, 173/16, 120/18, 122/21)
- Ligj për denacionalizim (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.20/98, 31/00, 42/03, 44/07, 72/10, 171/2010, 55/13, 33/15, 104/15),
- Ligj për tokë ndërtimore (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.275/19),
- Ligj për tokë bujqësore (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.135/07, 17/08, 18/11, 42/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13, 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16, 39/16, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.161/19, 173/21 dhe 91/23),
- Ligj për eksportpririm (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 95/12, 131/12, 24/13 27/14, 104/15, 192/15, 23/16, 178/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21 dhe 111/23),
- Ligji për banim (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.99/09, 57/10, 36/11, 54/11, 13/12, 55/13, 163/13, 42/14, 199/14, 146/15, 31/16, 64/18 dhe 302/20 dhe 150/22),
- Ligji për shitjen e banesave në pronësi shoqërore ("Fleta zyrtare e RSFJ" nr. 36/90, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 62/92, 7/98, 24/03, 24/11 dhe 144/ 14)
- Ligji për noteriat (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.72/16, 142/16, 233/18),
- Ligji për transtormimin e ndërmarrjeve në kapital shoqëror (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/93, 48/93, 21/98, 25/99, 81/99, 49/00, 6/02, 31/03, 38/04, 35/06, 84/07, 123/12, 25/15),
- Ligj për gjueti (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.26/09, 82/09, 1/12, 69/13, 164/13, 187/13, 33/15, 147/15, 193/15, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.150/21,283/21 dhe 91/23),
- Ligji për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82/08,13/13, 156/15, 193/15),
- Ligj për qasje të lirë në informatat me karakter publik (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 101/2019).



Përveç kompetencave dhe autoriteteve që i ka me ligjet dhe akte nënligjore, Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut vepron rregullisht dhe në pajtim me Konkluzionet e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Avokatët e Shtetit marrin pjesë gjithnjë në mënyrë aktive në seancat e Komisioneve të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe në seancat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit 2022 në punën e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vend në të madh zënë lëndët kontestimore dhe lëndët administrative.

Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut merr pjesë në procedurat për tjetërsimin e tokës ndërtimore të ndërtuar dhe të pandërtuar duke dhënë mendim të duhur, privatizimin e saj, në pajtim me Ligjin për privatizimin dhe qiradhënien e tokës ndërtimore në pronësi shtetërore, si dhe për tjetërsimin e pasurive të tjera të palujtëshme shtetërore, shkëmbimi i tokës bujqësore në pajtim me nenin 16 dhe vazhdim i kontratës të qirasë në tokën bujqësore, në pajtim me nenin 39 nga Ligji për tokën bujqësore.

Pjesëmarrja aktive e Avokaturës së Shtetit në procedurën për tjetërsimin e tokës ndërtimore jo të ndërtuar, në pronësin e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe për tjetërsimin e pasurisë tjetër të palujtëshme në pronësi të shtetit, bazohen në nenin 56 të Ligjit për noterin.

Në pajtim me nenin 56 nga Ligji për noter, roli i Avokatit të Shtetit në dhenie të mendimit ka një rëndësi të madhe. Në rast të përgatitjes së dokumentit noterial mbi bazë e të cilit kryhet transferimi i pronësisë, ndarja fizike të patundshmërisë, përkatësisht shkëmbimi i pasurisë së patundshmërive, ku njëra nga palët kontraktuese paraqitet Republika e Maqedonisë së Veriut, noteri është i detyrar të marrë mendime nga Avokati i Shtetit. Noteri do ta shtyjë përgatitjen e dokumentit derisa të jepet mendimi, më së voni prej 30 (tridhjet) ditësh. Nëse Avokati i Shtetit nuk jep mendim brenda afatit të caktuar, noteri do të përgadisë dokumentin noterial sikur të ishte dhënë mendim pozitiv. Dokumentet noteriale të përgatitura në kundërshtim me dispozitat e këtij neni nuk kanë statusin e dokumentit publik dhe nuk prodhojnë efekte juridike.

Kontestet që zhvillohen në procedura gjyqësore ku Avokatura e Shtetit e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqitet si përfaqësues sipas ligjit të Republikës



së Maqedonisë së Veriut dhe organeve të saj, janë arsye të ndryshme, nga të cilat si më e zakonshme dhe domethënëse mund të përmenden në vijim:

-Kontestet për përcaktimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e parajftuar;

-Kontestet për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, në bazë të dënuar në mënyrë të padrejtë ose privimit të padrejtë të lirisë; për shkak të konfiskimit të paligjshëm të lëndëve në procedurat penale dhe kundërvajtjes; si dhe kompensim të dëmeve për arsye të tjera;

-Kontestet në lidhje me anulimin e kontratave të lidhura nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në veçanti kontratat e lidhura në procedurat për tjetërsimin ose dhënie me qira të pronës shtetërore (tokë ndërtimore, tokë bujqësore) kontratat e lidhura në procedurat për përkorimin publikë dhe kontratat e tjera kur Republika e Maqedonisë së Veriut ose prej organeve të saj, paraqitet si palë kontraktuese, nëse ekzistojnë bazë ligjore për anulimin e tyre;

-Kontestet në lidhje me mbledhjen e borxheve për arsye të ndryshme, qoftë në rast se Republika e Maqedonisë së Veriut ose organi i saj paraqitet si kreditor ose debitorë;

-Kontestet e punës në të cilat organet shtetërore janë më shpesh të paditura për procedurat e zhvilluara dhe vendimet në procedurat disiplinore, gradë e papaguar të karrierës dhe përcaktimin se nëpunësat shtetëror kanë fituar një shkallë të karrierës, për shkak të mosmarrjes të vendimit për të marrë shkallë karriere, pagesa e shpërblyerit jubilar, pagesa e shtesave të pagës për punë jashtë orarit, punë nga marrëdhëniet e ndryshme-punë natën, punë në turne, punë festa, punë me rrezik të lartë, etj.

-Kontestet për përcaktimin e të drejtës së kontestuar në procedurë falimentimi.

